



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Shkurt 2021

Nr: 82

**VENDIM**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE NR. 35, DATË 16.12.2020 “PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE  
SPECIFIKIMEVE TË VULAVE ME KOD SIGURIE QË DO TË PËRDOREN NË  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, pika 2, shkronja “b”, nenin 100, paragrafi 4, dhe 101, paragrafi 1, shkronja “e”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 144 të ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N:**

Modelet dhe specifikimet teknike të vulave me kod sigurie, që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020, “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

Numri i kodit të sigurisë së vulës, duhet të shquhet qartë dhe lehtësisht për të lehtësuar punën e komisionerëve gjatë kryerjes së procedurave të dokumentimit të marrjes në dorëzim nga KZAZ, shpërndarjes e tyre për KQV-të, pasqyrimit të tij në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, si dhe plotësimit të procesverbaleve të dorëzimit të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutive të matërialeve të votimit në VNV.



Data: 16 Shkurt 2021

Nr. 82

Për disa ndryshime në Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”

Dorëzimi i materialeve të votimit në VNV nga KQV-të kryhet jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit. Edhe për respektim të këtij afati, stampimi më ngjyrë të zezë i kodit të sigurisë në trupin plastik të vulës do të ndihmonte dhe lehtësonte punën e komisionerëve zgjedhorë në kryerjen e procedurave të dorëzimit të materialeve të votimit dhe dokumentimin e tyre në procesverbalet përkatës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19 paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 144, paragrafi 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **V E N D O S A:**

Në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020, “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“2.Vulat me kodet e sigurisë që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, do të kenë trupin plastik me ngjyrë të bardhë, ku me ngjyrë të zezë stampohet kodi i sigurisë.”

2. Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“3. Vulat shtesë me kod sigurie që do të përdoren vetëm në rast dëmtimi të vulave më ngjyrë bardhë, për mbylljen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit, do të kenë trupin plastik me ngjyrë të verdhë ku me ngjyrë të zezë stampohet kodi i sigurisë.”



3. Në lidhjen 1, “kodi i sigurisë së vulës do të stampohet me ngjyrë jeshile në trupin e çdo vule” bëhet “kodi i sigurisë së vulës do të stampohet me ngjyrë të zezë në trupin e çdo vule”.

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

